

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTRIJSKO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. Org. Unit	M-01	Nr. i Prot. Broj Prot.	6810/22
Nr. i Faqeve Br. Stranica	05	Data Date	09.11.22

PRISHTINË / A No. 1

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - OPSTINA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT

Nr. i Prot.	02	9505
Nr. i Faq.	5	Data 15.11.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture/
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Hani i Elezit
Opština Elez Han
Municipality of Hani i Elezit

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES TË

MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

DHE

KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

PËR

FINANCIMIN E PROJEKTIT "Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha" në Han të Elezit"

Prishtinë, 2022

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 Mars, 2019), Nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr. 28/04 Qershor 2008), Kodit 19045 të paraparë në Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, (Gazeta Zyrtare, Nr. 13/21 Dhjetor 2021), palët e kësaj marrëveshje:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilën e përfaqëson Ministri Liburn Aliu, në tekstin vijues MMPHI.

dhe

2. Komuna e Hanit të Elezit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës, Mehmet Ballazhi në tekstin vijues Komuna

lidhin:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha"

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin vijues "Marrëveshja" është të krijoj lidhje bashkëpunimi në mes MMPHI-së dhe Komunës së Hanit të Elezit, për realizimin e projektit "Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha"

Neni 2 Fushëveprimi

Palët pajtohen që të bashkëpunojnë në zhvillimin e projektit "Rregullimi i parkut në rrugën 'Isa Berisha' ", për vitin 2022.

Neni 3 Vlera e projektit dhe mënyra e Bashkëfinancimit

1. MMPHI financon këtë projekt në vlerë prej: 100,000.00 €, për vitin buxhetor 2022, nga Kodi buxhetor 19040. Realizimi i projektit prej fillimit deri në fund të kontratës do ta mbikëqyrë zyrtari monitorues, të cilin do ta caktoj MMPHI-ja.
2. Çdo tejkallim i vlerës së planifikuar do të mbulohet nga Komuna.

Neni 4 Obligimet e Komunës

1. Komuna e Hanit të Elezit obligohet:
 - 1.1 të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgojnë në Ministri;
 - 1.2 të krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projektit "Rregullimi i parkut në rrugën 'Isa Berisha' " për operatorin ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesa të filloj implementimin e projektit me kohë si dhe të siguroj specifikacionet teknike;
 - 1.3 që projektin ta zhvilloj në pajtim me Ligjin përkatës mbi Prokurimin Publik, Ligjit përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve;
 - 1.4 të kryej procesin e tenderimit dhe caktoj komisionin për hapjen e ofertave dhe vlerësimin të tenderit;
 - 1.5 të emëroj projekt menaxherin, organi mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve, pranimin teknik, në të cilin komision duhet të jetë një anëtar nga MMPHI-ja. Projekt menaxheri, organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve, furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve, furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës;
 - 1.6 të njoftoj MMPHI-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, dhe për këtë të kërkoj pëlqimin nga MMPHI-ja.
 - 1.7 në vend punishte obligohet të vendos tabelën informuese me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik;
 - 1.8 të ndërmarr të gjitha masat që projekti të përfundoj në përputhje me ndarjet buxhetore sipas viteve. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës;
 - 1.9 të njoftoj MMPHI-në për rrjedhat e realizimit të projektit deri në përfundim.
 - 1.10 të ndërmarr dhe të kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projektit përfshirë procedurat dhe kompensimin.
2. Komuna obligohet që për realizimin e pagesave, për punët, furnizimet e kryera në nivel të financimit nga MMPHI-ja të kompletoj këto dokumente:

- 2.1 Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korigjuara);
- 2.2 Kopjen e kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik, së bashku me ofertën financiare, të vërtetuara në bazë të origjinalit nga menaxheri i prokurimit të Komunës;
- 2.3 Vendimin mbi emërimin e projekt menaxherit, organit mbikëqyrës dhe komisionit për pranim teknik nga Komuna.
- 2.4 Raportin nga projekt menaxheri, organit mbikëqyrës dhe komisionit të pranimit për punët dhe furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara);
- 2.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MMPHI-ja; dhe
- 2.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse është i regjistruar në SMIFK - Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave dhe Transfereve).

Neni 5 Obligimet e MMPHI-së

1. MMPHI-ja i siguron mjetet buxhetore në vlerë prej 100,000.00€, për vitin 2022.
2. Pagesat për financimin e projektit nga MMPHI-ja do të behët në pajtim me realizmin e punimeve / furnizimeve sipas kushteve të kontratës.
3. MMPHI-ja cakton një zyrtar për mbikëqyrjen e realizimit të projektit nga fillimi deri në përfundim të kontratës.
4. MMPHI-ja me vendim do të caktoj detyrat, përgjegjësit dhe autorizimet e zyrtarit për mbikëqyrje.

Neni 6 Ndryshimi, plotësimi dhe ndërprerja e Marrëveshjes

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MMPHI-së dhe Kryetarit të Komunës, kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MMPHI-ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i ka përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 7
Zgjidhja e kontesteve

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo Marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 8
Numri i kopjeve

Marrëveshja është hartuar në dy (2) kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga një (1) kopje.

Neni 9
Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim do të kaloj në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 10
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje të filloj të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Liburn Aliu

Minister i MMPHI



Mehmet Ballazhi

Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit

M. Ballazhi